



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 534 Prot.

Tiranë, më datë 19.02.2020

VENDIM

Nr. 55, datë 19.02.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 48 dhe neni 134 dhe V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit të relacionit të verifikimit të gjetjeve arkeologjike në zonën arkeologjike “A” në kuadër të punimeve të UKD, realizuar nga specialistët e DSHA dhe Qendrës Muzeore Durrës, më parë në Këshillin Teknik të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 19.02.2020,

VENDOSI:

1. Miratimin e relacionit mbi verifikimin e gjetjeve arkeologjike në terren në kuadër të punimeve që po kryhen nga Ndërmarrja Ujësjellës Kanalizime Durrës, në zonën arkeologjike "A" të qytetit të Durrësit, realizuar nga DSHA dhe Qendrës Muzeore Durrës;
2. Specialistët e DSHA të realizojnë dokumentimin e saktë të gjetjeve arkeologjike të konstatuara;
3. Subjekti UKD të depozitojë projektin pranë IKTK për shqyrtim dhe vendimarrje në KKTKM;
4. Deri në vendimarrje nga KKTKM për këtë projekt, investitori duhet të sigurojë kantierin dhe gjetjet arkeologjike *in situ*;
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
6. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

KRYETAR

Elva MARGARITI

